



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 347 Akti

Nr. 331 Vendimi
Tiranë, më 11.1.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Suela Zhegu	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 7.1.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Igerta M. Hysi**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5, e nenit 179/ b, të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 12.11.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 18.11.2019 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisioner Olsi Komici. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Theo Jacobs.

3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si KLGJ).

5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016,

¹ Raport dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2019.

si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi “*papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Igerta M. Hysi*”.

7. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 17.12.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, dhe njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

10. Për një proces të rregullt ligjor, znj. Igerta Hysi, i janë garantuar të drejtat: (i) për t’u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t’u njohur me përbërjen e trupit gjykues; si dhe (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Në datën 21.12.2020 për sa rezultoi nga hetimi administrativ i procesit të rivlerësimit, subjektit iu dhanë 14 ditë kohë për t’u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

11. Znj. Igerta Hysi, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj në datën 4.1.2021. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit, deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 5.1.2021.

13. Seanca dëgjimore u zhvilluan në datën 7.1.2021, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

14. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

² Me shkresën nr. ***** prot., datë 31.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. **, datë 28.2.2020, të KDZH-së.

³ Me shkresën nr. ***** prot., datë 1.12.2020.

15. Subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

18. Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19. Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar, *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGj-ja;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj.

Igerta Hysi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore; (ii) burimet e krijimit të kësaj pasurie; (iii) të ardhurat; (iv) shpenzimet; si dhe (v) mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konfliktin e interesit.

Në deklaratën e pasurisë, *Vetting*, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në datë 26.1.2017, subjekti ka deklaruar pasuritë, si vijon:

1. Apartament banimi⁴, me sip. 101.6 m², në Durrës, blerë në vlerën 44.500 euro

Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se kjo pasuri është blerë me kursimet e familjes së saj dhe është likuiduar para martesës mbi bazën e të ardhurave kryesisht nga paga e babait, z. M.B dhe të ardhurave të siguruara nga emigracioni i vëllait në shtetin grek, z. M.B.

Në DPV-në e parë në vitin 2010, subjekti ka deklaruar se pasuria është krijuar me të ardhurat nga kursimet familjare pa specifikuar kontributet e secilit.

1.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ZVRPP-ja Durrës⁵, ka konfirmuar pasurinë e llojit apartament me sip.101.6 m² në bashkëpronësi të subjektit me bashkëshortin me nr. ***-nd+***, vol. **, f. **, z. k. ***.

1.2 Analiza e fakteve

Referuar akteve ligjore të cilat janë përdorur për porositjen e pasurisë, rezulton se për llogari të subjektit është bërë një pagesë për blerje apartamenti në shumën 44.500 euro, sipas kontratës

⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë porosie nr. *****, datë 16.7.2010, me palë sipërmarrëse shoqëria "T" dhe palë porositëse Igerta Bengu i apartamentit nr. *, në katin e *-të në godinën **-katëshe me sip.102.2 m² (2+1), në vlerën 44.500 euro, e likuiduar nga pala porositëse. Vërtetim nr. ***, datë 11.10.2016.
- Kontratë porosie nr. *****, datë 12.12.2010, me palë sipërmarrëse shoqëria "T" dhe palë porositëse Igerta Bengu i apartamentit nr. * në katin e *-të në godinën **-katëshe me sip.111.7 m² (2+1), në vlerën 44.500 euro, e likuiduar nga pala porositëse. Vërtetim nr. ***, datë 11.10.2016.
- Kontratë shitblerje me nr. *****, datë 29.5.2013, me palë shitëse shoqëria juridike "T" sh.p.k. dhe palë blerëse E. H dhe Igerta Hysi të pas. nr. ****-ND**+***, në z. k. ****, vol. ***, f.*** ,në adresën K.T /* Durrës, lloji pasurisë apartament me sip.101.6 m², në vlerën 45.500 euro. Vërtetim nr. **, datë 11.10.2016.
- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 28.6.2013, në emër të E. H dhe Igerta Hysi te apartamentit me sip.101.6 m² me nr. pasurie ****-ND**+***, në z. k. ****, vol. ***, f.**, në adresën K.T /* D. Harta treguese e regjistrimit.
- Deklaratë noteriale, nr. **** prot., datë 6.10.2014, deklaruesi M.B deklaroi se e motra tij Igerta Bengu, ka blerë një apartament nga shoqëria "T" sh.p.k., Durrës. Në blerjen e apartamentit, deklaruesi ka kontribuar në shuma monetare me të cilën është blerë apartamenti, pasi ka pasur mundësi ekonomike, punonte si emigrant në Greqi prej shumë vitesh. Vërtetim nr.*** rep., datë 11.10.2016.
- Dokumentacion në gjuhën greke. Kartelë likuidimi në emër të M. B nga Zyra e Tatimeve, të ardhurat nga puna në Mykonos, për vitin 2005 në vlerën 2.195 euro, viti 2006 në vlerën 4.274 euro, viti 2007 në vlerën 8.622 euro, viti 2008 në vlerën 5.713 euro, viti 2009 në vlerën 6.625 euro, viti 2010 në vlerën 7.745 euro, viti 2011 në vlerën 7.535 euro, viti 2012 në vlerën 7.882 euro, viti 2013 në vlerën 7.051 euro. Vërtetim nr. **** rep.. datë 27.10.2016.
- Dokumentacion në gjuhën greke. Ekstrakt i llogarisë i sigurimeve shoqërore, në emër të M. B për periudhën maj 2008 - dhjetor 2008, janar 2009- prill 2009-nëntor 2009, prill 2007- tetor 2007, janar 2006 - nëntor 2006, prill 2005 - dhjetor 2005, korrik 2004 - tetor 2004. Vërtetim nr. **** rep., datë 27.10.2016.
- Deklaratë noteriale nr. *****, datë 22.10.2016, deklaruesi M.B, deklaroi se vajza e tij Igerta Hysi (Bengu), ka blerë një apartament në v.2010, nga shoqëria "T" sh.p.k., në Durrës. Në blerjen e apartamentit, deklaruesi ka kontribuar financiarisht kurse nga paga dhe puna e djalit të tij M. B si emigrant ekonomik në Greqi, prej shumë vitesh. Kopje e ID-së.
- Nxjerrje llogari bankare, për periudhën, nga data 1.1.2006 – 2.3.2009, në "Alpha Bank", në emër të M.B, në të cilën kreditohen pagat në vlerën rreth 2.500.000 lekë. Nxjerrje llogari bankare, për periudhën, nga data 16.10.2006 – 2.3.2009, "Alpha Bank", në emër të M.B.
- Nxjerrje llogari bankare, për periudhën, nga data 1.3.2009 – 31.12.2010, Alpha Bank, në emër të M.B.
- Nxjerrje llogari bankare, datë 29.9.2010 – 13.1.2017, në "Emporiki Bank" dhe "Abi Bank" në emër të M. B në të cilën kreditohet paga në vlerën 212.822 lekë.
- Nxjerrje llogari bankare, datë 26.10.2016, në "Raiffeisen Bank", në emër të M.B, në të cilën kreditohet paga për vitet 2009 – 2010 në vlerën 1.359.923 lekë.
- Nxjerrje llogari bankare nga data 1.11.2007 – 31.12.2010, në "Tirana Bank" në emër të V.B, në të cilën i kreditohet paga për vitet 2007 – 2010 në shumën 557.134 lekë.
- Nxjerrje llogari bankare, datë 26.10.2016, në "Raiffeisen Bank", në emër të V. B, në të cilën kreditohet paga.

⁵ Me shkresën nr. ***** prot., datë 12.10.2020, drejtuar ZQRPP-së , për ILDKPKI-në.

së porosisë nr. *****, datë 16.7.2010. Referuar kontratës së porosisë, në të cilën është specifikuar që palët janë likuiduar plotësisht, si dhe deklarimeve të subjektit, Komisioni për efekt të kryerjes së analizës financiare ka konsideruar datën e nënshkrimit të kësaj kontrate, si moment të blerjes së pasurisë apartament.

Në deklaratën *Vetting*, por edhe në deklarinimin përpara fillimit të detyrës, subjekti nuk ka specifikuar se sa janë kontributet e vëllait dhe të babait, që janë përdorur për krijimin e kësaj pasurie. Për këtë arsye, për efekt të analizës financiare u pyet subjekti, e cila shpjegoi⁶ se: *“Në lidhje me përcaktimin në mënyrë shteruese të kontributit të babait M. B dhe vëllait M.B për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 101.6 m², në vlerën prej 44.500 euro, i qëndroj të gjitha deklarimeve të mëparshme. Kjo pasi, ashtu siç e kam shpjeguar, të ardhurat e familjes sime që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, kanë qenë pasuri e akumuluar ndër vite dhe administrohej si një e vetme nga ana e babait. Në lidhje me vlerën e kontributeve të babait dhe vëllait tim në blerjen e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 101.6 m², jam në pamundësi objektive për të dhënë shifra veçmas për secilin prej tyre, pasi të ardhurat nga emigracioni i vëllait tim në shtetin grek, si dhe të gjitha të ardhurat e familjes time, administroheshin nga babai. Për këtë arsye, deklaroj se e kam të pamundur të deklaroj saktë kontributin e babait dhe vëllait tim të ndarë veçmas”*.

Komisioni ka vlerësuar të analizojë burimet e ligjshme të kontribuesve në mënyrë kumulative, meqenëse subjekti nuk mundi të deklarojë të ndarë veçmas kontributin e secilit, në blerjen e apartamentit.

Nga administrimi i akteve në dosje ka rezultuar një kontratë porosie me nr.****, datë 16.7.2010, me palë sipërmarrëse shoqërinë “T” sh.p.k. dhe palë porositëse Igerta Bengu, për porositjen e një apartamenti në katin e *-të në godinën **-katëshe me sip. 102.2 m², në vlerën 44.500 euro. Referuar kontratës ka rezultuar se pala porositëse ka bërë likuidim të plotë të çmimit të apartamentit nga pala porositëse, paguar *cash*.

Palët kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes me nr. ****, datë 29.5.2013, me palë shitëse shoqërinë juridike “T” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasit E.H dhe Igerta Hysi të pasurisë pasurisë apartament me sip. 101.6 m². Pasuria apartament është regjistruar në ZVRPP-në Durrës, në emër të subjektit dhe bashkëshortit, sipas certifikatës për vërtetim pronësie me nr. **, datë 28.6.2013.

Subjekti u pyet nga Komisioni për datën e kryerjes së pagesave, si dhe të dokumentojë pagesat e kryera prej saj.

Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se: *“... pagesa e vlerës prej 44.500 euro është bërë nga babai M.B. Kjo pagesë është bërë cash, ditën e përpilimit të kontratës së porosisë për ndërtim apartamenti me nr. ****, datë 16.7.2010. Pagesa për likuidimin e apartamentit është kryer para fillimit të detyrës sime si gjyqtare dhe konkretisht, në datën 16.7.2010, kur ndërmjet meje në cilësinë e porositësit, shoqërisë ‘T’ sh.p.k., në cilësinë e palës sipërmarrëse, dhe shtetasit O. Xh, në cilësinë e nënkontraktorit, është lidhur kontrata e porosisë për ndërtim apartamenti.*

*Koha e kryerjes së pagesës rezulton e provuar nga përmbajtja e kontratës së porosisë për ndërtim apartamenti, me nr.*****, datë 16.7.2010, ku në faqen nr. * të saj, në nenin 3: “Mënyra e likuidimit. Pagesa është kryer me para në dorë dhe palët me vullnetin e tyre të lirë e kanë deklaruar dhe pranuar në kontratën e lidhur ndërmjet tyre, që pagesa është likuiduar e plotë nga ana e porositësit jashtë zyrës noteriale, para nënshkrimit të kontratës përkatëse...”*

⁶ Në përgjigje të pyetësorit të datës 6.11.2020 ardhur me shkresën nr. ***** prot., datë 12.11.2020.

Komisioni, nga verifikimi i akteve në dosje, vëren se pasuria apartament është blerë në vitin 2010 dhe është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratën para fillimit të detyrës. Subjekti në datën 21.12.2011 është emëruar në detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Subjekti ka lidhur martesë në datën 29.7.2011, vërtetuar kjo me certifikatën e martesës⁷ të datës 2.12.2019.

Kontrata e shitblerjes me nr. *****, datë 29.5.2013, është nënshkruar nga subjekti dhe bashkëshorti. Lidhur me këtë fakt, subjekti ka shpjeguar⁸ se: *“Pasuria apartament është fituar para martese, burimi i krijimit kanë qënë të ardhurat e familjes sime. Në kohën e lidhjes së kontratës së shitblerjes nr. *****, datë 29.5.2013, kishte lidhur martesën ligjore me bashkëshortin E. H. Për shkak të përbërjes familjare, në kohën e lidhjes së kontratës së shitjes, bashkëshorti, është përfshirë në kontratën e shitjes, për shkak të ligjit. Kjo pasi, zyra e regjistrimit, në regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, i referohet certifikatës së përbërjes familjare në kohën e kalimit të pronësisë. Pra, bashkëshorti është bërë bashkëpronar në këtë pasuri, për shkak të ligjit dhe jo për shkak të kontributit të tij për blerjen e këtij apartamenti. Në lidhje me faktin nëse bashkëshorti ka patur kontribut në mobilimin e këtij apartamenti, Ju sqaroj se, në kohën e mobilimit të këtij apartamenti kemi qënë të martuar, për rrjedhojë, dhe kontributi në mobilimin e këtij apartamenti ka qënë i përbashkët”*.

Referuar kontratës së porosisë nr. *****, datë 16.7.2010, subjekti ka porositur një apartament me sip. 102.2 m². Më tej, me kontratën e porosisë nr. *****, datë 12.12.2010, është porositur një apartament me sip. 111.7 m². Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti ka deklaruar ndryshimin e sipërfaqeve për apartamentin e porositur: *“Apartament banimi ndryshuar sipërfaqja nga 102 m², në 111,7 m², porositur me kontratën nr. *****, datë 12.12.2010”*. Sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 29.5.2013, është shitur pasuria apartament me sip.101.6 m².

➤ Komisioni ka evidentuar mospërputhje lidhur me sipërfaqet e apartamentit referuar akteve: kontratës së porosisë finale, me kontratën e shitblerjes.

E pyetur nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se: *“Në kontratën e shitjes, në pjesën e sipërfaqes totale, janë përfshirë dhe pjesët e përbashkëta, që ndodhen në bashkëpronësi të detyrueshme të të gjithë pronarëve të njësisive individuale, në përputhje me kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi, përveç njësisë, e cila është në pronësi individuale. Për efekt të regjistrimit, pasuritë e përcaktuara në aktin e bashkëpronësisë së detyrueshme nuk pasqyrohen në certifikatën për vërtetimin e pronësisë, e cila pasqyron vetëm njësinë individuale, pra sipërfaqen reale që ndodhet në pronësinë ekskluzive të pronarit të njësisë individuale*.

*Mbështetur në sa më sipër, në certifikatën për vërtetimin e pronësisë nr. *****, datë 28.6.2013, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, pasqyrohet sipërfaqja totale e apartamentit të blerë, pa përfshirë pjesët e përbashkëta që ndodhen në bashkëpronësi të detyrueshme të të gjithë pronarëve të njësisive individuale, në raport me sipërfaqen e njësisë individuale që zotëron secili prej tyre”*.

✓ Nga hetimi i kryer, ka rezultuar se pasuria është porositur dhe likuiduar përpara se subjekti të emërohej në detyrën e gjyqtares dhe, gjithashtu, është pasuri e krijuar përpara martesës.

✓ Subjekti ka shpjeguar bindshëm mospërputhjet e sipërfaqeve të pronës.

1.3 Analiza financiare

⁷ Ky akt është depozituar me përgjigjet e pyetësorit standard.

⁸ Në përgjigje të pyetësorit të datës 6.11.2020 ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 12.11.2020.

Komisioni ka analizuar burimet e ligjshme të personave të lidhur, për krijimin e kësaj pasurie në përputhje me pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. Analiza financiare e kryer nga Komisioni për këtë pasuri është bazuar në dokumentacionin ligjor të depozituar nga subjekti, duke analizuar: (i) të ardhurat e ligjshme të prindërve; si dhe (ii) të ardhurat e vëllait, si emigrant ekonomik në shtetin grek.

a) Të ardhurat e ligjshme të prindërve të subjektit

Subjekti ka depozituar:

- deklaratë noteriale nr. *****, datë 22.10.2016, lëshuar nga shtetasi M.B, i cili deklaron, ndër të tjera, se në blerjen e apartamentit ka kontribuar financiarisht me kursimet nga paga e tij dhe puna e djalit M.B, si emigrant ekonomik në Greqi, prej shumë vitesh;
- statement bankare të “Alpha Bank”, “Raiffeisen Bank” dhe “Emporiki Bank”, ku provohen kalimet e pagave nga shoqëria “D” sh.p.k., ku shtetasi M.B ka qenë i punësuar si mekanik;
- vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nga Drejtoria e Arkivit Qëndror Tiranë, ku provohen të ardhurat e tatueshme të shtetasit M. B për periudhën tetor 2006 – korrik 2010;
- subjekti në përgjigje të pyetësorit ka depozituar edhe vërtetim nga ISSh-ja Elbasan, ku ka rezultuar se shtetasi M.B ka punuar për periudhën 1981 – 2000, si mekanik në Elbasan dhe në Gramsh;
- kopje të librezës së sigurimeve shoqërore, si dhe vërtetim mbi bazën e vlerësueshme të lëshuar nga ISSh-ja Durrës për shtetasen V.B (nëna e subjektit), për të ardhurat e siguruara nga puna si shitëse pranë shoqërisë “D- 2001” sh.p.k., për periudhën prill 2004 – shkurt 2006;
- statement bankarë të “Tirana Bank” ku ka rezultuar se znj. V.B ka marrë pagë në llogarinë e saj për vitet 2006 – 2010.

Komisioni kreu përlllogaritjen e të dhënave (tabela vijuese), mbi të ardhurat e ligjshme të babait, nënës dhe të ardhurat e subjektit nga Shkolla e Magjistraturës, deri më 16.7.2010, sipas kontratës së porosisë, për të analizuar mundësitë për të kursyer me burime të ligjshme.

Përshkrimi	2006 – 16.7.2010
Të ardhura babai	4 453 887
Të ardhura nëna	579 379
Të ardhura subjekti	1 020 000
Të ardhura totale	6 053 266
Shpenzime jetese	1 968 111
Blerje automjeti në vitin 2007	492 022
Likuiditete në bankë (më 16.6.2010)	555 131
Mundësia për të kursyer	3 038 002

✓ Nga analizimi i dokumentacionit ligjor, duket se familja e subjektit ka pasur mundësi për të kursyer nga viti 2006 – 2010, shumën prej 3.038.002 lekësh (e konvertuar në euro me kursin mesatar të vitit 2010, është rreth 21.886 euro).

b) Të ardhurat e ligjshme të vëllait

Komisioni ka administruar dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti, në lidhje me të ardhurat e ligjshme të vëllait, të siguruara në shtetin grek nga punësimet në vite, si vijon:

- deklaratë noteriale nr. *****, datë 6.10.2014, lëshuar nga deklaruesi M.B (vëllai i subjektit), në të cilën deklaroi se e motra, znj. Igerta Bengu, ka blerë një apartament nga shoqëria “T” sh.p.k., në Durrës dhe se ka kontribuar në shuma monetare, në blerjen e këtij apartamenti, pasi ka pasur mundësi ekonomike, duke qenë se punonte si emigrant ekonomik në shtetin grek prej shumë vitesh;
- vërtetim lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore të shtetit grek, ku kanë rezultuar të ardhurat nga puna në ishullin e Mykonos, ndër vite, për të cilat janë paguar detyrimet ndaj shtetit për periudhën 2004 – 2016;
- vërtetim nga autoritetet tatimore greke, ku provohen të ardhura nga subvencionet (asistencë) për z. M. B për periudhën 2006 – 2010.

Nga analizimi i të dhënave (tabela vijuese), ka rezultuar se vëllai i subjektit ka pasur mundësi për të kursyer nga viti 2004 – 2010, shumën prej 15.777 euro.

Viti	Të ardhura të deklaruara	Subvencione	Minimumi jetik në shtetin grek	Diferenca
2004	2 914		5 300	-
2005	7 624		5 650	1 974
2006	9 462		5 910	3 552
2007	6 688	2 162	6 120	2 730
2008	7 887	2 017	6 480	3 424
2009	8 548	1 272	6 897	2 923
2010	8 352	-	7 178	1 174
Total	48 561	5 451	38 235	15 777

Nga analizimi i burimeve të ligjshme, mbi të ardhurat e prindërve dhe vëllait, duket se kanë pasur mundësi për të kursyer në total shumën prej 37.663 euro.

➤ Nga verifikimi i të dhënave bankare të babait të subjektit në “Alpha Bank” për periudhën 2009 – 2010, u evidentuan transfertat të dërguara nga Greqia, nga shtetasit:

- M.H (bashkëshorti tezes së subjektit) - transferuar në llogarinë e z. M.B, shumën 4.393 euro.
- F. L (daja i subjektit) - transferuar në llogarinë e z. M.B, shumën 4.400 euro.

Lidhur me këto dy transaksione, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se: *“Babai më ka shpjeguar se, ato kanë qenë të ardhurat e vëllait tim në shtetin grek. Vëllai në atë periudhë kohe jetonte në të njëjtin apartament me shtetasin F. L, i cili është daja im (vëllai i nënës V.B). Ndërkohë, shtetasi M. H është bashkëshorti i tezes sime, shtetases R.H, të cilët prej vitesh kanë jetuar dhe jetojnë aktualisht në ishullin Mykonos, Greqi, në të njëjtin vend ku ka jetuar dhe punuar për një kohë të gjatë vëllai M.B”.*

Për sa më sipër, referuar të dhënave bankare të babait të subjektit, u evidentua se këto transfertat janë kryer përpara blerjes së apartamentit dhe përpara se subjekti të fillonte detyrën si gjyqtare.

Nga analizimi i burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit, ka rezultuar se personat e lidhur, familjarë të subjektit, kanë qenë në pamundësi financiare, në shumën **6.837 euro ose në shumën **949.055 lekë**.**

Në lidhje me këtë konsatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

1.4 Qëndrimi i subjektit

Në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni për pamundësinë financiare të personave të lidhur në shumën 6.837 euro, subjekti ka argumentuar, si vijon:

i. Referuar të dhënave të pasqyruara në tabelën mbi përlllogaritjen e të ardhurave të ligjshme të babait, nënës dhe të ardhurave të saj nga Shkolla e Magjistraturës deri në datën 16.7.2010, rezulton se në pjesën “Blerje e makinës në vitin 2007”, është shënuar vlera 492.022 lekë. Rezulton se kjo vlerë është zbritur nga shuma e të ardhurave të ligjshme të grumbulluara, ndër vite, të familjes dhe që kanë shërbyer në blerjen e apartamentit që disponon subjekti aktualisht. Ndërkohë, referuar çmimit të blerjes së makinës në vitin 2007 nga babai i subjektit, rezulton se është në shumën 250.000 lekë, sipas kontratës përkatëse pjesë e dosjes. Subjekti ka pretenduar se shuma që duhet të zbritet nga këto të ardhura duhet të jetë në vlerën 250.000 lekë dhe jo në vlerën 492.022 lekë.

ii. Në lidhje me të ardhurat e ligjshme dhe shpenzimet e minimumit jetik të vëllait, për periudhën 2004 – 2010, subjekti ka pretenduar se në këtë analizë financiare nuk janë përlllogaritur subvencionet (asistencë) që vëllai ka përfituar për vitin 2010, ku subvencioni ditor është në vlerën 18.17 euro, pra, në total ka përfituar për vitin 2010 vlerën prej 3.007,13 euro. Gjithashtu, referuar tabelës në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga puna në emigracion e të vëllait rezulton se vlera totale e tyre për periudhën 2004 – 2010 është përlllogaritur nga Komisioni në shumën 48.561 euro. Subjekti ka pretenduar se në rastin konkret është bërë një gabim në përlllogaritje, pasi nga mbledhja aritmetike e këtyre të dhënave rezulton se në total ato arrijnë shumën prej 51.475 euro.

Sipas dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me të ardhurat e vitit 2010, rezulton se të ardhurat janë në vlerën prej 8.749 euro. Subjekti ka vënë në dispozicion një kopje të këtij dokumentacioni në formën e kërkuar nga ligji, të përkthyer, të noterizuar dhe me vulë apostile.

1.5 Arsyetimi ligjor

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosje dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivleresimit, ka konstatuar se pretendimi i subjektit për të ardhurat e të vëllait në emigracion është i drejtë dhe të ardhurat shtesë të dokumentuara për vitin 2010, përfshirë dhe subvencionin janë marrë në konsideratë duke u reflektuar në analizën përfundimtare.

Në lidhje me pretendimin e mospërfshirjes së të ardhurave të vitit 2004, Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë për vitin në fjalë të ardhurat, pasi ato janë shumë më të ulëta se minimumi jetik për atë vit në shtetin grek, duke e konsideruar mundësinë e kursimit zero për vitin 2004.

Gjithashtu, pretendimi i subjektit për vlerën e autoveturës së blerë nga babai në vitin 2007, nuk qëndron, pasi referuar dokumentacionit të administruar është përlllogaritur si vlerë totale edhe zhdoganimi i mjetit.

Pas prapësimeve, nga analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të personave të lidhur familjarë, ka rezultuar një balancë negative në shumën 470.788 lekë.

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosje dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivleresimit, vlerëson faktin se krijimi i të ardhurave dhe blerja e pasurisë apartament, janë veprime që kanë ndodhur përpara se subjekti të merrte detyrën e gjyqtarës dhe çdo burim i përdorur për krijimin e kësaj pasurie është krijuar nga familjarë të saj, përpara se subjekti të fillonte detyrën si gjyqtarë. Për këto arsye, balanca negative që rezultoi nga analiza financiare, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivleresimit.

Përfundimisht, u konkludua se subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë apartament, ka shpjeguar bindshëm burimet e ligjshme për krijimin e këtij aseti, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

2. Tokë bujqësore⁹ me sip. 6.270 m², me ¼ pjesë takuese, në fshatin Kodovjat, Gramsh

Nga kjo, sipërfaqja prej 5.970 m² e llojit arrë dhe sipërfaqja prej 300 m² truall, janë fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi me nr. ***, datë 1.10.1992. Subjekti zotëron 1/4 pjesë të pasurisë.

2.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ZVRPP-ja Gramsh, ka konfirmuar pasuritë në emër të babait të subjektit, të përfituara me ligjin me nr. 7501/1991, në cilësinë e përfaqësuesit të familjes bujqësore. Bashkëlidhur akti i marrjes së tokës në pronësi nr. ***, datë 1.10.1992, në emër të shtetasit M.B, në Gramsh, tokë bujqësore në total me sip. 6.270 m², nga e cila 5970 m² tokë arë dhe 300 m² truall dhe 50 m² pemtore.

✓ Subjekti ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë , në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

3. Pasuria¹⁰ e llojit “arë” me sip. 301 m², ndodhur në fshatin B, Durrës, në pronësi të bashkëshortit. Blerë në shumën 68.327 lekë, me të ardhurat nga paga si i punësuar në Bashkinë Durrës.

Kjo pasuri është deklaruar në DPV-në e vitit 2011 si “tokë arë” me sip. 301 m², me burim nga të ardhurat nga pagat, blerë me kontratën e shitblerjes me nr. ****, datë 2.2.2011.

3.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ZVRPP-ja Durrës¹¹, konfirmon se shtetasi E. H ka në pronësi pasurinë nr. ***, vol.*, f. **, z. k. ***, e tipit “arë” me sip. 301 m². Bashkëlidhur është vendosur kartela e pasurisë së paluajtshme në emër të shtetasit E. H të tokës arë me sip. 301 m², në vlerën 68.327 lekë me kontratë shitjeje.

3.2 Analiza e fakteve

Kjo pasuri është blerë nga bashkëshorti i subjektit përpara martesës. Referuar aktit ligjor, martesë e subjektit me bashkëshortit është lidhur në datën 29.7.2011. Gjithashtu, rezulton se kjo pasuri është blerë nga bashkëshorti përpara se subjekti të emërohej në detyrën e gjyqtarës.

Në dosje rezulton kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 2.2.2011, me palë shitëse shtetasit M. Gj, A.Gj, A.Gj, S.Gj, P.Gj, K.Gj, R.Gj, B.M(Gj), M.N(Gj), dhe palë blerëse shtetasin E.H, të pasurisë tokë arë me nr. ***, vol. **, f. ***, z. k. ***, me sip. 301 m². Çmimi i pasurisë

⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- akti i marrjes së tokës në pronësi nr. ***, datë 1.10.1992, në emër të M.B, në Gramsh, tokë bujqësore me sip. 6.270 m², nga e cila 5970 m² tokë arë dhe 300 m² truall dhe 50 m² pemtore. Vërtetim nr.**** rep., datë 12.11.2016;
- vërtetim nga Këshilli i Qarkut Gramsh, datë 27.12.2016, konfirmon se M. B ka në pronësi ose përdorin në fushë (kodër – mal) sip. 5.970 m².

¹⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

certifikatë për vërtetim pronësie nr.****, datë 25.3.2011, në emër të E.H, pasuria me nr. ****, z k. ***, vol. **, f. ***, Durrës, adresa B, e llojit arë me sip. 301 m²; harta treguese e regjistrimit.

Kontratë shitblerje, tokë arë nr. ****, datë 2.2.2011, me palë shitëse shtetasit M.Gj, A.Gj, A.Gj, S.Gj, P.Gj, K.Gj, R.Gj, B.M(Gj), M.N (Gj), dhe palë blerëse shtetasin E.H të pasurisë nr. ****, vol.*, f. ***, z. k. **** me sip.301 m² në vlerën 68.327 lekë; vërtetim nr. *** rep., datë 11.10.2016.

¹¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.7.2017, drejtuar ZQRPP për ILDKPKI.

përcaktuar në kontratë është në shumën 68.327 lekë, shumë e cila ishte likuiduar nga blerësi jashtë zyrë noteriale.

3.3 Analiza financiare

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, bazuar në të dhënat e depozituara për të ardhurat nga paga e bashkëshortit të subjektit, ka rezultuar se ka pasur mundësi financiare për të blerë pasurinë “tokë arë”, në fshatin Bizë, Durrës.

✓ Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë e bashkëshortit, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

4. Depozitë bankare¹² në “Credins Bank”, në shumën 959.416,23 lekë, në datën 21.10.2016, e çelur në datën 20.10.2014, me afat dyvjeçar.

Subjekti ka deklaruar se burimi i krijimit të kësaj depozitë është krijuar nga shitja e automjetit “Mercedez-Benz” ML*** CDI, me targa AA *** IX, në çmimin 900.000 lekë, sipas kontratës nr. *****, datë 9.9.2014.

4.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

“Credins Bank”¹³, ka konfirmuar depozitën në shumën 950.503 lekë në datën 26.1.2017.

DPSHTRr-ja¹⁴, konfirmon se znj. Igerta Hysi dhe personat e lidhur me të nuk kanë në pronësi mjete të regjistruara pranë saj.

4.2 Burimi i krijimit

Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, si dhe në DPV-në e vitit 2014, se burimi i krijimit për këtë depozitë ka rezultuar nga shitja e automjetit “Mercedez Benc” ML*** CDI, me targa AA ***** IX, kundrejt çmimit 900.000 lekë, sipas kontratës nr. *****, datë 9.9.2014.

Subjekti ka deklaruar se automjeti është blerë me kredinë e marrë nga bashkëshorti në vlerën 500.000 lekë, sipas kontratës së lidhur në datën 1.6.2010 me “Intesa Sanpaolo Bank”. Kjo kredi është maturuar në datën 6.6.2013. Shlyerja e saj është realizuar me të ardhurat nga paga e bashkëshortit si i punësuar në Bashkinë Durrës.

4.3 Analiza e fakteve

Subjekti i ka bashkëlidhur dokumentacionit kontratën për shitje automjeti me nr. ***, datë 9.9.2014, sipas të cilës rezulton se automjeti “Mercedez-Benz”, me targa AA *** IX është shitur në çmimin 900.000 lekë. Çmimi është paguar i plotë dorazi, jashtë zyrës noteriale.

¹² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë depozitë, datë 20.10.2014, në “Credins Bank”, nga z. E. H në shumën 900.000 lekë, me afat 24 muaj; derdhe në depozitë, datë 20.10.2014, në “Credins Bank”, në vlerën 900.000 lekë nga z. E. H; librezë depozitë; vërtetim nr. *** rep., datë 12.11.2016; buletini i depozitave.
- Nxjerrje llogari bankare, datë 21.10.2016, në “Credins Bank”, në emër të E.H me depozitë të çelur në datën 20.10.2014, në vlerën 900.000 lekë. Maturuar depozita në vlerën 959.416 lekë mbajtur tatim mbi fitimin në vlerën 8.912 lekë, mbetur vlere e depozitës pas tatimit 950.503 lekë.
- Kontratë shitje automjeti nr. *****, datë 9.9.2014, me palë shitëse E. H dhe palë blerëse I. A të mjetit Mercedes Benz tipi ML *** CDI, me targa AA *** IK në vlerën 900.000 lekë; regjistri i barrës siguroese; vërtetim nr. *** rep., datë 11.10.2016; deklaratë doganore në emër të E. H; certifikatë e regjistrimit në Mbretërinë e Bashkuar; dokument në gjuhën angleze; leje qarkullimi të mjetit me targa AA *** X.
- Dokument nga “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 12.10.2016, e cila vërteton se z. E. H ka marrë një kredi bankarë në vlerën 500.000 lekë me qëllim blerjen e autoveturës në datën 1.6.2010 e shlyer kredia më 6.6.2013; kontratë kredi bankare datë 1.6.2010, me palë kredidhënës “Intesa Sanpaolo Bank” dhe palë kredimarrëse E.H dhe dorëzanës K. H në vlerën 500.000 lekë, kredia do të shlyhet deri më 1.6.2013; vërtetim nr. *** rep., datë 22.10.2016; amortizim kredie bankare, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

¹³ Me shkresën nr.*** prot., datë 1.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

¹⁴ Me shkresën nr. ***** prot., datë 31.10.2020, drejtuar ILDKPKI-së.

Nga aktet e dosjes ka rezultuar se shtetasi E. H ka nënshkruar kontratën e depozitës në datën 20.10.2014, me afat dyvjeçar.

Në dosje rezulton, gjithashtu, një shkresë nga “Intesa Sanpaolo Bank” e datës 12.10.2016, me të cilën konfirmohet se z. E.H ka lidhur kontratë kredie në datën 1.6.2010 dhe është disbursuar, për shumën 500.000 lekë për blerje autoveture, me afat shlyerje 3-vjeçar. Kjo kredi është mbyllur në datën 6.6.2013.

4.4 Analiza financiare

Automjeti “M-B” është blerë nga bashkëshorti i subjektit përpara lidhjes së martesës. Sipas deklaratës së zhdoganimit të mjetit ka rezultuar se shuma e paguar për blerjen e automjetit në vitin 2010 ka qenë 300.000 lekë dhe taksa e doganës në shumën 64.352 lekë. Në total është paguar shuma 364.352 lekë.

Gjithashtu, ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit, z. E. H, ka marrë kredi në shumën 500.000 lekë në “Intesa Sanpaolo Bank”, e cila është përfshirë në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

➤ Nga analizimi i të dhënave, rezultoi e paqartë vlera totale e shpenzuar për blerjen e automjetit. Pasi është përdorur katër vjet, më pas, automjeti është shitur me çmim më të lartë nga sa është blerë, pra, në shumën 900.000 lekë.

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

4.5 Qëndrimi i subjektit

Subjekti në prapësimet e datës 4.1.2021, ka shpjeguar se sikurse është deklaruar nga bashkëshorti, automjeti është blerë në vlerën 500.000 lekë dhe si burim për krijimin ka shërbyer kredia e marrë në “Intesa Sanpaolo Bank” në vlerën prej 500.000 lekësh. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se referuar deklaratës së zhdoganimit të mjetit ka rezultuar se shuma e paguar për blerjen e automjetit në vitin 2010 ka qenë 300.000 lekë dhe taksa e doganës në shumën 64.352 lekë, subjekti argumenton se pagesa për blerjen e këtij automjeti është kryer në momentin e marrjes së kredisë në shumën 500.000 lekë. Vlera prej 300.000 lekësh që referohet në deklaratën e zhdoganimit nuk është çmimi i blerjes së këtij automjeti, por ajo përfaqëson vlerën doganore që shteti ka përcaktuar për këto lloje automjetesh në momentin e zhdoganimit, për efekt të zhdoganimit të automjetit, pavarësisht se sa është blerë ky automjet. Nga dokumentacioni përkatës, rezulton që automjeti është blerë në vitin 2010, ndërsa zhdoganimi i tij është bërë në datën 20.2.2014. Në bazë të përcaktimeve ligjore, vlera 300.000 lekë që citohet në deklaratën e zhdoganimit të automjetit përbën, pikërisht, vlerësimin doganor të automjetit në kohën e zhdoganimit dhe jo çmimin e blerjes, i cili është 500.000 lekë.

Në lidhje me çmimin e shitjes së automjetit në shumën 900.000 lekë, pasi është përdorur për 4 vjet, subjekti ka shpjeguar se burimi i krijimi të këtij automjeti ka qënë kredia nga “Intesa Sanpaolo Bank”, në vlerën prej 500.000 lekësh. Kjo kredi është maturuar në vitin 2013 dhe vlera totale e paguar për shlyerjen e saj ka qënë në shumën prej 663 434.43 lekësh. Mjeti është shitur në vitin 2014, pasi është zhdoganuar. Vlera e paguar për zhdoganimin e automjetit ka qënë 64.352 lekë. Duke mbledhur vetëm këto dy shuma rezulton se vlera e shpenzuar për këtë automjet është 727.786 lekë. Duke përfshirë edhe shpenzime të tjera që lidhen me kryerjen e pagesave të taksës vjetore, targimin e makinës, siguracion dhe shërbime të tjera të domosdoshme për mirëmbajtjen e tij, rezulton se çmimi i shitjes së tij është real për kohën dhe llojin e automjetit, në vlerën që është përcaktuar në kontratën e shitjes.

Arsyetimi ligjor

Komisioni vlerëson faktin se automjeti është blerë në vitin 2010 nga z. E. H, i cili nuk gëzonte statusin e bashkëshortit të subjektit dhe nuk kishte detyrimin të dispononte aktin e blerjes së automjetit. Shpjegimet e dhëna nga subjekti, në lidhje me çmimin e blerjes së automjetit në shumën 500.000 lekë, janë të pranueshme dhe bindëse, për faktin se subjekti ka deklaruar se z. E. H ka lidhur një kontratë kredie në datën 1.6.2010 dhe është disbursuar në shumën 500.000 lekë, për blerje autoveture, me afat shlyerje 3-vjeçar.

Në lidhje me shpjegimet e subjektit në prapësime se çmimi i shitjes është real, pasi vlera e shpenzuar për këtë automjet është në shumën 727.786 lekë, është përsëri vlerë më e ulët nga çmimi i shitjes së automjetit në shumë n 900.00 lekë, pasi u përdorur për 4 vjet. Këto shpjegime nuk duken bindëse, pasi me kalimin e viteve, vlera e automjeteve për vetë natyrën e tyre dhe konsumimin nga përdorimi, bie dhe nuk rritet. Kostot që ka përballuar subjekti për mirëmbajtje apo shpenzimet për pagesat e detyrueshme taksa, siguracione, etj., nuk rrisin vlerën e automjetit, nëse nuk është bërë ndonjë investim konkret.

Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin e njohur që në Shqipëri tregu i automjeteve të përdorura funksionon i tillë, madje funksionon si një biznes mjaft fitimprurës (pasi makinat blihen jashtë vendit me një çmim shumë më të lirë nga çfarë shiten në tregun e lirë), në këto kushte, vlerëson se kontrata e shitblerjes është një marrëdhënie juridike private bazuar mbi një vullnet kontraktor të lirë të palëve, për pasojë, vendosja e çmimit është në vullnet të palëve.

Trupi gjykues, në analizë të deklaratimeve të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara dhe ato të administruara gjatë hetimit, konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi burimin e krijimit të depozitës bankare, si dhe ka provuar nëpërmjet kredisë bankare mundësitë financiare për burimin e krijimit të saj, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

5. Llogari kursimi¹⁵ “Fonde për të ardhmen e fëmijës”, e hapur në datën 5.5.2014, në “Intesa Sanpaolo Bank”, dega Durrës, në favor të vajzës së mitur S.H, me vlerë 337.523 lekë, në datën 9.1.2017. Burimi i krijimit të kësaj llogarie janë nga të ardhurat nga paga e bashkëshortit të subjektit, si i punësuar në Bashkinë Durrës.

“Intesa Sanpaolo Bank”¹⁶, ka konfirmuar se në datën 26.1.2017, llogaria rrjedhëse është me gjendje në shumën 337.523 lekë.

✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.

6. Llogari rrjedhëse¹⁷ nga paga në emër të bashkëshortit të subjektit, z. E. H, në Bashkinë Durrës. Vlëra: 86.37 lekë. Pjesa takuese: 100%.

“Intesa SanPaolo Bank”¹⁸, ka konfirmuar se z. E.H, ka pasur llogari page pranë kësaj banke.

✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.

7. DETYRIME FINANCIARE¹⁹

¹⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë “Fonde për të ardhmen e fëmijës” në “Intesa Sanpaolo Bank” në emër të vajzës S.H, në vlerën 200.000 lekë, datë 5.5.2014; vërtetim nr. *** rep., datë 12.11.2016.

• Nxjerrje llogarie bankare datë 9.1.2017, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të S. H, me gjendje në llogari në vlerën 337.523 lekë.

• Vërtetim datë 9.1.2017, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të S. H, me gjendje në llogari në vlerën 337.523 lekë.

¹⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.2.2020 drejtuar ILDKPKI-së

¹⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogari bankare datë 10.1.2017, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të E. H, me llogari rrjedhëse në vlerën 86 lekë.

¹⁸ Me shkresën nr. **** prot., datë 7.2.2020

¹⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

Subjekti ka deklaruar se për shkak të një kredie të marrë nga i vëllai, ka dalë dorëzanë në këtë marrëdhënie.

Subjekti ka shpjeguar se vëllai ka blerë një pasuri të paluajtshme, në Tiranë, dhe për këtë shkak ka marrë kredi me nr. *****, datë 2.7.2015, në shumën 14.000.000 lekë, sipas “Marrëveshjes së financimit dhe dorëzanie” të lidhur ndërmjet Bankës së Bashkuar të Shqipërisë dhe shtetasve M, V dhe M.B, për financimin nga BBSH-ja të dyqanit me sip. 118.4 m², në objektin e ndërtuar nga shoqëria “P.C.A” sh.p.k., me afat shlyerje 180 muaj.

Për këtë arsye, subjekti me bashkëshortin kanë dalë garantor/dorëzanës në marrëveshjen e financimit nga BBSH-ja.

7.1 Hetimi i Komisionit

ZQRPP-ja Tiranë²⁰ ka konfirmuar se pasuria në bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortit, me nr. *****-nd+*****, vol. ***, f. ***, z. k. *****, të llojit apartament me sip. 101.6 m², është e hipotekuar në pronësi të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë.

ASHK-ja Drejtoria Vendore Tiranë Jug²¹ ka konfirmuar se në emër të shtetasve M.V.B dhe M.M.B është regjistruar pasuria me nr. *****N**, z. k.****, vol. ***, f. ***, e llojit njësi me sip. 117.4 m², me vendndodhje në “Rruga e Kavajës”. Bashkëlidhur është kartela e pasurisë së paluajtshme të njësisë me sip. 117 m², pronë e cila është hipotekuar në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, sipas kontratës së hipotekimit.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë²² ka konfirmuar vendosjen e apartamentit si garanci hipotekore nga shtetasit Igerta dhe E. H, për kredinë e marrë nga personat e lidhur (familjarë të subjektit).

QKB-ja²³ konfirmon se shtetasi M.B figuron i regjistruar si Person Fizik, i pajisur me NIPT L****O, me objekt veprimtarie “bar-kafe”.

DRT-ja Tiranë²⁴ informon se shtetasi M.M.B figuron i regjistruar si Person Fizik me NIPT L****O, me aktivitet “bar-kafe”, me adresë aktiviteti: Njësia Bashkiake Nr. *, “Rruga e Kavajës”, ish-parku i autobusave, Tiranë, me datë regjistrimi 11.3.2016, në QKB.

-
- vërtetimin nr. *** rep., datë 14.10.2016.; marrëveshje financimi dhe dorëzanie nr. *****, datë 2.7.2015, me Bankën e Bashkuar të Shqipërisë, me klientët M.B, V. B, M. B dhe dorëzanës Igerta Hysi dhe E.H. Banka ka dhënë një kredi financiare në vlerën e 14.000.000 lekë, me qëllim blerjen e një dyqani me sip. 118.4 m² në “Rrugën e Kavajës”, Tiranë, me çmimin 130.000 euro;
 - kontratën e hipotekimit nr. *****, datë 2.7.2015, me Bankën e Bashkuar të Shqipërisë dhe palë hipotekuese janë shtetasit M.B, V.B, I.H dhe E.H, të pasurisë nr. ***, vol. **, f. **, z. k. ***, Durrës, lloji i pasurisë truall me sip. 90 m², dhe ndërtesa 2-katëshe me sip. 106 m², mbi të, në adresën: lagjia nr.**, Spille Durrës, në emër të shtetasit M.B. Pasuria nr. **** ND** +**, vol. **, f. **, z. k. ***, Durrës e tipit apartament nr. ** me sip. 101.6 m² në lagjen nr. 2 “S. E”, Durrës, në emër të shtetasve E.H dhe I.H; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, datë 27.2.2013, në emër të shtetasit M.B; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 28.6.2013, në emër të shtetasve E.H dhe Igerta Hysi. Harta treguese e regjistrimit;
 - nxjerrjen e llogarisë bankare, datë 26.10.2016, nga “Raiffeisen Bank”, në emër të shtetasit M.B;
 - vërtetimin datë 24.1.2017, nga UBA ose Banka e Bashkuar e Shqipërisë, në të cilën vërtetohet se shtetasi M.B ka marrë një kredi në vlerën 14.000.000 lekë, në datën 8.7.2015, me afat 15-vjeçar, ka detyrim të mbetur në vlerën 13.095.653 lekë;
 - nxjerrjen e llogarisë bankare datë 24.10.2016, nga UBA në emër të shtetasit M.B, në të cilën në datën 8.7.2015, është disbursuar kredia në vlerën 14.000.000 lekë dhe në datën 10.7.2015, është kryer pagesa në “P.C.A” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë kontratë porosie nr. *** ”, në vlerën 13.600.000 lekë; pagesat e kështit të kredisë janë kryer nga shtetasit M.B dhe M.B;
 - nxjerrjen e llogarisë bankare, datë 13.1.2017, nga BKT-ja, në emër të shtetasit M. B, në të cilën kreditohet paga për periudhën 1.1.2014 – 6.1.2017;
 - nxjerrjen e llogarisë bankare, nga data 1.1.2011 – 31.12.2014, nga “Tirana Bank” në emër të shtetasit V.B;
 - nxjerrjen e llogarisë bankare, datë 26.10.2016, “Raiffeisen Bank”, në emër të shtetasit V.B, në të cilën kreditohet paga;
 - nxjerrjen e llogarisë bankare, datë 26.10.2016, “Raiffeisen Bank”, në emër të shtetasit M.B, në të cilën kreditohet paga;
- ²⁰ Me shkresën nr. **** prot., datë 10.8.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Durrës.
- ²¹ Me shkresën nr. **** prot., datë 24.3.2020.
- ²² Me shkresën nr. **** prot., datë 12.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.
- ²³ Me shkresën nr. **** prot., datë 5.2.2020.
- ²⁴ Me shkresën nr. **** prot., datë 6.2.2020.

Nga hetimi i kryer ka rezultuar se subjekti ka deklaruar saktë si detyrim financiar edhe marrëdhënien e ngushtë familjare lidhur me cilësinë e dorëzanesës, për shkak të një kredie të marrë nga babai dhe vëllai i saj. Komisioni ka vlerësuar se dorëzania është një veprim juridik aksesor në raport me detyrimin kryesor dhe përbën një garanci personale, që ka për qëllim të shtojë mundësinë dhe alternativat e debitorit për të realizuar të drejtën e tij të kredisë.

✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.

8. Automjet në përdorim

Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit është përdoruese e automjetit me targa DR **** E.

DPSHTRr-ja²⁵ ka depozituar dosjen e këtij automjeti. Nga aktet rezulton se automjeti me targa DR **** E, e llojit “W.G”, është në pronësi të babait të subjektit, z. M.B. Nga dosja rezulton se ky shtetas me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 12.12.2007, ka blerë këtë automjet në shumën 250.000 lekë. Nga sistemi i AMF-së rezulton se pronar i këtij automjeti është z. M.B dhe të drejtë përdorimi për këtë automjet në vite ka pasur edhe subjekti me të vëllain M.B. Përdorimi i këtij automjeti është deklaruar nga subjekti në përgjigjet e pyetësorit standard, të ardhura me shkresën nr. *** prot., datë 13.12.2019.

✓ Nga hetimi i kryer, shpjegimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e administruar në dosje.

Analiza financiare përmblledhëse për periudhën 2009 – 2016

	PASURI	DIFERENCE LIKUIDITETI	LIKUIDITETE (FUND VITI)	DETYRIME	PASURI NETO	TE ARDHURA	SHPENZIME	REZULTATI FINANCIAR
2009	90 000	90 000	90 000	-	90 000	927 182	136 620	700 562
2010	222 329	222 329	312 329	435 339	- 213 010	1 103 340	136 620	1 179 730
2011	874 398	306 071	618 400	285 899	588 500	1 147 815	401 368	157 947
2012	187 863	187 863	806 263	108 480	79 383	1 357 435	960 519	317 533
2013	- 2 484	- 2 484	803 779	-	- 2 484	1 396 304	436 034	962 755
2014	721 959	721 959	1 525 738	-	721 959	2 128 536	1 263 503	143 074
2015	164 800	164 800	1 690 538	-	164 800	1 653 749	1 035 811	453 138
2016	39 582	39 582	1 730 120	-	39 582	1 640 281	1 097 559	503 140

Nga analiza financiare e kryer për periudhën 2009 – 2016 ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme për të krijuar pasuritë dhe për të përballuar shpenzimet ndër vite.

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

²⁵ Me shkresën nr. **** prot., datë 5.10.2020.

Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit vërehet se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë dhe nuk janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga subjekti i rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, deklarimet e subjektit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin. Subjekti ka burime të ligjshme financiare për krijimin e tyre.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ku fillimisht:

✓ **DSIK-ja ka konstatuar papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Igerta Hysi në detyrën e gjyqtarit.**

Në lidhje me verifikimin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, Komisioni administroi dosjet gjyqësore, si vijon:

1. Dosje penale në ngarkim të të pandehurve B. F, B.N dhe A.N

Këta shtetas ishin akuzuar për veprën penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 259 – 25, të Kodit Penal. Në informacion referohej se fillimisht relatorja ka qenë e prerë që të pandehurit të dënoheshin.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier²⁶ ka depozituar dosjen penale që i takon vendimit nr. 8, datë 14.1.2015, me të pandehur B. F, B.N dhe A.N.

Gjatë gjykimit, të pandehurit kanë depozituar kërkesë për gjykim të shkurtuar të çështjes, kërkesë e cila mori aprovim edhe nga prokurori i çështjes. Nga verifikimi i akteve rezultoi se subjekti, në këtë çështje, ka qenë në cilësinë e anëtares së trupës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, referuar nenit 404 të Kodit të Procedurës Penale, vlerësoi se në gjendjen që ishin aktet e dosjes çështja mund të zgjidhej dhe, për pasojë, pranoi kërkesën e të pandehurve për gjykim të shkurtuar.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. *, datë 14.1.2014, ka vendosur: “*Deklarimin fajtor të të pandehurve B. F, B.N dhe A. N për kryerjen e veprës penale ‘Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike’ , kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 259 dhe 50/gj dhe në bazë të këtij neni dënimit e tyre me 3 vjet burgim.*

Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurve i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht dënohen me 2 vjet burgim.

Në vijim, gjykata ka disponuar se në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, për pjesën e pavuajtur të dënimit, ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për një afat prej 2 vjetësh me kusht që të pandehurit të mos kryejnë vepra të tjera penale dhe të mbajnë kontakte me shërbimin e provës Fier. Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal ndalohen të

²⁶ Me shkresën nr. ***** prot., datë 28.9.2020.

pandehurit për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 1 viti. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurve”.

Të pandehurit kanë bërë ankim kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 18.10.2016, ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit nr. *, datë 14.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”.

✓ **Nga shqyrtimi i akteve, që i takon dosjes penale në ngarkim të të pandehurve B. F, etj., nuk u konstatuan shkelje ligjore të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Sipas shkresës nr. ****, datë 28.9.2020, të ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, çështja ndodhet për gjykim në Gjykatën e Lartë.**

2. Dosja me të pandehur shtetasin E. D

Nga informacioni i disponuar, referohet se një shtetas me të dhënat A. F i ka dhënë një shumë parash prokurorit të çështjes që të mos bënte ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë. Në përfundim, trupi gjykues ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm të të pandehurit, pasi gjykata vendosi të pezullojë dënimin për një periudhë 2-vjeçare.

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes rezulton se shtetasi E. D është akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje narkotikësh”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, pasi këtij shtetasi i është gjetur në xhep lëndë e llojit kanabis sativa rreth 8 gr.

Prokurori i çështjes ka kërkuar deklarinim fajtor të të pandehurit E. D, për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje narkotikësh”, si dhe dënimin e tij 5 vjet për veprën penale të kryer. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, *të pandehurit t’i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht dënohet me 3 vjet e 4 muaj burgim.*

Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, për pjesën e pavuajtur të dënimit, pezullimin e ekzekutimit të pjesës së mbetur të dënimit me burgim për të pandehurin E. D, duke e vendosur atë në provë për një periudhë 3-vjeçare me kusht që të pandehurit të mos kryejnë vepra të tjera penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të ndalohej të shoqërohet me persona të dënuar për vepra penale.

Bazuar në kërkesën e të pandehurit për gjykimin e shkurtuar të çështjes, kërkesë që mori aprovim edhe nga prokurori i çështjes, u pranua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier pasi referuar nenit 404 të Kodit të Procedurës Penale u vlerësua se në gjendjen që ishin aktet e dosjes çështja mund të zgjidhej.

Në përfundim, gjykata, me anëtar trupi (jo relator) subjektin e rivlerësimit, ka disponuar me vendimin nr. ***, datë 15.6.2016, ku vendosi: “1. Të deklarojë fajtor të pandehurin E. D për kryerjen e veprës penale prodhim dhe shitje narkotikësh”, si dhe dënimin e tij 5 vjet për veprën penale të kryer. 2. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit ti ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht dënohet me 3 vjet e 4 muaj burgim. 3. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, për pjesën e pavuajtur të dënimit, pezullimin e ekzekutimit të pjesës së mbetur të dënimit me burgim për të pandehurin E. D, duke e vendosur atë në provë për një periudhën 2 vjet e 4 muaj, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepra të tjera penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës Fier dhe të mos kryejë vepra të tjetër penale e të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht të dënuar...”

Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 28.6.2016.

✓ Nga shqyrtimi i akteve, vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është gjetur e bazuar në ligj dhe prova. Trupi gjykues ka vendosur masën e dënimit të kërkuar nga prokurori i çështjes. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

3. Dosja që i përket shtetasit/të pandehurit K.Dh

Informacioni i referuar është për një çështje penale të vitit 2018, në ngarkim të shtetasit K Dh, akuzuar për veprën penale “shpërdorim të detyrës” me kallëzues shtetasin K. D. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier janë zhvilluar 5 seanca. Trupi gjykues, me relatores Igerta Hysi, ka vendosur pushimin e çështjes.

Referuar akteve të depozituara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, ky shtetas ka rezultuar në cilësinë e kallëzuesit në çështjen penale me të njëjtin numër dhe vit, ndërkohë që informacioni i disponuar referon se shtetasi K.Dh ishte në cilësinë e të akuzuarit për veprën penale “shpërdorim të detyrës”

✓ **Informacioni nuk përputhet me të dhënat e dosjes penale.**

4. Informacioni i referuar i takon çështjes penale nr. *, me gjyqtare Igerta Hysi, për të pandehurit G.H dhe M.H, akuzuar për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal.**

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me urdhrin datë 6.11.2012, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. ***, viti 2012, për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal. Me urdhrin, datë 20.9.2014, organi i akuzës ka urdhëruar shënimin në kolonën përkatëse të regjistrit të njoftimit të veprave penale edhe të emrit të shtetasve M.H dhe G.H, si persona të cilëve iu atribuohet kryerja e veprës penale të mësipërme.

Gjatë procesit gjyqësor, në seancën e datës 4.5.2016, pala mbrojtëse ka depozituar disa akte shkresore/certifikata për vërtetim pronësie të pasurive për të cilat ishte regjistruar procedimi penal.

Përfaqësuesja e organit të akuzës është shprehur se këto akte shkresore, për sa kohë i referohen pasurisë për të cilën të pandehurit janë akuzuar, duhet të administroheshin nga gjykata dhe pas administrimit të tyre, përfaqësuesja e organit të akuzës, konform nenit 377 të Kodit të Procedurës Penale, kërkoi kthimin e akteve në ngarkim të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, me qëllim kryerjen e veprimeve të tjera hetimore në kuadër të provueshmërisë së akuzës së ngritur.

Në këto rrethana, gjykata ka vlerësuar se në kuadrin që ishin provat e marra në shqyrtim gjatë gjykimit, nuk mund të konkludohet në mënyrë bindëse për pafajësinë e të pandehurve. Po kështu, gjykata çmon se nuk konkurrojnë as rastet e pushimit të çështjes. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 15.6.2016, ka vendosur: “*kalimin e akteve të çështjes penale në ngarkim të të pandehurve M.H dhe G.H, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier*”.

Bazuar në ankimin e bërë nga të pandehurit M.H dhe G.H, të cilët pretendonin pafajësinë, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 8.5.2018, ka vendosur: “*lënien në fuqi të vendimit gjyqësor penal nr. ***, datë 15.6.2016*”.

Çështja ka vijuar gjykimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, por me një tjetër gjyqtar.

✓ **Nga aktet e shqyrtuara për këtë rast nuk u evidentua ndonjë veprim i subjektit që mund të cenonte figurën apo aftësitë e saj profesionale.**

5. Në lidhje me një informacion për një bisedë të datës 9.10.2013, ndërmjet shtetasit të identifikuar si S. J dhe av. V, e cila shprehet se një javë më parë duhet të jepej shuma e premtuar (1.000 euro).

Në mungesë të një informacioni të saktë, Komisioni ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës së Apelit Vlorë, për dosje gjyqësore të shqyrtuara, në ngarkim/emër të shtetasit S.J.

✓ **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier²⁷ dhe Gjykata e Apelit Vlorë²⁸ referojnë se në lidhje me shtetasin S.J, nga verifikimi i bërë në sistemin ICMIS, nuk ka rezultuar që të jetë shqyrtuar ndonjë çështje në ngarkim të tij.**

6. Nga një informacion i bërë publik në median online, referohet se në vitin 2014, Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar nga KLD-ja inspektim dhe vlerësim të procedurave që janë ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, për vendimmarrjen dhe lirimin nga gjykatat shqiptare të tre shtetasve A. G, B.Q (A.I) dhe E. S, të cilët kërkoheshin nga drejtësia italiane për trafik droge.

Prokurori i Përgjithshëm ka pretenduar se vendimi për moszgjatjen e afateve të masës shtrënguese për shtetasin A.I është i pabazuar në ligj dhe në prova, është precedent dhe cenon marrëdhëniet e besimit të mirë dhe të reciprocitetit të institucioneve shqiptare dhe vetë shtetit shqiptar me shtetet e huaja.

Për këtë informacion, Komisioni i është drejtuar KLGJ-së, duke i kërkuar praktikën përkatëse dhe rezultatin e inspektimit.

Nga verifikimi i akteve, depozituar nga KLGj-ja, ka rezultuar se nga ana e këtij institucioni u verifikua ankesa e Prokurorit të Përgjithshëm për mosrespektim formal të ligjit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në lidhje me dy vendimet gjyqësore të marra nga subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi.

Subjekti i rivlerësimit, gjyqtarja Igerta Hysi, në përfundim të gjykimit të çështjes për një nga të pandehurit, me:

- vendimin nr. ***, datë 15.7.2014 (brenda 5 ditëve), ka vendosur *rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier për zgjatjen e afateve të paraburgimit*; si dhe me
- vendimin nr. ***, datë 17.7.2014 (brenda 5 ditëve) ka vendosur *pranimin e kërkesës. Konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në burg” caktuar ndaj shtetasit A.I me vendimin nr. ***, datë 11.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Pas ankimit të bërë nga prokurori, Gjykata e Apelit Vlorë, me shumicë votash, me vendimin nr. ***, datë 15.8.2014, ka vendosur miratimin e vendimit nr. ***, datë 17.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ndërsa me vendimin nr. ***, datë 15.8.2014, ka vendosur miratimin e vendimit nr. **, datë 17.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë,

– me vendimin nr. ***, datë 2.10.2014, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të prokurorit të Apelit Vlorë ndaj vendimit nr. **, datë 15.8.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë (me anë të tij ishte vendosur miratimi i vendimit nr. ***, datë 17.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”, objekt verifikimi (për zgjatjen e afateve të masës shtrënguese);*

²⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.9.2020.

²⁸ Me shkresën nr. ***prot., datë 30.9.2020.

– me vendimin nr. ***, datë 20.11.2014, ka vendosur: “*Mospranimin e rekursit të prokurorit të Apelit Vlorë ndaj vendimit nr. ***, datë 15.8.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë, me anë të tij ishte vendosur miratimi i vendimit nr. ***, datë 17.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, objekt verifikimi (për shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg”)*”.

Pas përfundimit të shqyrtimit të çështjes, në të tria shkallët e gjyqësorit, nga ana e inspektorëve të ish KLD-së, është sugjeruar arkivimi i ankesës, datë 30.12.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në lidhje me informacionin e bërë publik në media, vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është konfirmuar nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë. Gjithashtu edhe nga inspektimi i kryer nga ish-KLD-ja, nuk u evidentuan shkelje ligjore të pretenduara si të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

✓ **Nga shqyrtimi i akteve, vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është gjetur e bazuar në ligj dhe në prova.**

Komisioni, pasi analizoi çështjet e mësipërme në të gjithë dinamikën e tyre, nuk konstatoi ndonjë shkelje ligjore të kryer nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nuk u evidentua ndonjë veprim i subjektit që mund të cenonte figurën apo aftësitë e saj profesionale.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elementë që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter u bazua në analizimin e:

- raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor²⁹ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij); dhe
- denoncimeve të paraqitura nga publiku sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit është bërë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në:

- formularin e vetëdeklarimit;
- tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, të dhënat nga burime arkivore; si dhe
- pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

Në lidhje me formularin e vetëdeklarimit, nga verifikimi i kryer ka rezultuar se subjekti ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi këtë formular.

²⁹ Sipas shkresës me nr. **** prot., datë 27.12.2019.

Vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit është kryer duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit, si:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Aftësitë profesionale

Në lidhje me aftësitë profesionale ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit dhe identifikon normën ligjore të zbatueshme. Subjekti i rivlerësimit kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile objekt shqyrtimi. Subjekti, në disa raste, i referohet vendimit të Gjykatës Kushtetuese të ligjit organik të saj, vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, si dhe ndryshimeve ligjore procedurale penale.

Aftësitë organizative

Subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, ndonëse ka pasur ngarkesë të lartë sasiore për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, gjithsej 1269 çështje gjyqësore, ka respektuar kohën në gjykim si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor dhe i ka gjykuar të gjitha çështjet brenda afateve standarde të gjykimit, qofshin çështje penale apo civile. Gjithashtu i ka kushtuar rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve gjyqësore, duke respektuar afatet ligjore në rastet e vëzhguara. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Igerta Hysi.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Igerta Hysi. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Igerta Hysi, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

Nga aktet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Igerta Hysi. Në asnjë prej dosjeve të vëzhguara, nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Në aktet e vëzhguara është konstatuar se gjyqtarja Igerta Hysi komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në gjykim. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve. Në aktet e vëzhguara nuk janë konstatuar dështim të seancave të planifikuara apo vonesa për fillimin e seancave gjyqësore, për shkak të mungesës së bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 18 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Të dhënat nga burime arkivore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2011. Subjekti i rivlerësimit ka kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në datën 21.12.2011 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Nga data 7.10.2020, me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor është komanduar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një periudhë 1-vjeçare.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Igerta Hysi përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

Denoncimet nga publiku

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka shqyrtuar 6 denoncimet e depozituara nga publiku ndaj gjyqtarës Igerta Hysi, së cilës iu kërkuan shpjegime në lidhje me dy denoncime.

1. Denoncim nr. *, datë 30.5.2018, depozituar nga shtetasja Zh. Q**

Denoncuesja ngre pretendime për dy subjekte rivlerësimi, për vendim të padrejtë. Denoncuesja shpjegon se ka fituar gjashtë gjyqe penale, por një prokurore dhe subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, kanë pushuar çështjen për të mbrojtur palën tjetër, pasi janë paguar nga pala tjetër.

Denoncuesja pretendon se eksperti F.P, që ka bërë aktekspertimin e caktuar nga prokurorja, ka qenë në konflikt interesi pasi ka qenë nëndrejtor i Hipotekës dhe dokumentet false që janë disponuar nga pala tjetër kanë dalë nga ZVRPP-ja Fier.

Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk i ka dhënë të drejtën e fjalës gjatë seancës gjyqësore, duke i mohuar të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor, etj.

Denoncuesja nuk ka depozituar asnjë akt për të mbështetur pretendimet e saj.

Në lidhje me këtë denoncim, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti, në prapësimet e datës 4.1.2021, ka shpjeguar se pretendimi i denoncueses Zh. Q është terësisht i pabazuar dhe i pavërtetë. Referuar vendimit nr. *****, datë 30.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që i takon denoncueses, rezulton se është vendosur pushimi i çështjes për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, bazuar në germat “c” dhe “ç”, të nenit 66/1, të Kodit të Procedurës Penale. Pra, gjykata në vendimmarrjen e saj ka konkluduar për kryerjen e veprës penale ndaj shtetasve të kallëzuar nga znj. Zh.Q dhe z. S. Q, duke iu dhënë të drejtë këtyre të fundit, por për shkak se nga ana e organit të Prokurorisë, brenda afatit 10-vjeçar, këta shtetas nuk janë marrë në cilësinë e të pandehurve, me kalimin e këtij afati, ndjekja penale nuk mund të ushtrohet për shkak se është parashkruar vepra penale.

Nga vlerësimi i akteve në dosje ka rezultuar qartë se nga gjykata nuk është favorizuar pala e kallëzuar nga denoncuesja dhe se çështja është pushuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Lidhur me pretendimet e ngritura ndaj ekspertit nuk rezultoi asnjë shkak papajtueshmërie e ekspertit F. P me detyrën e tij.

Pretendimet e ngritura nga denoncuesja nuk rezultuan të provuara. Vendimi i dhënë nga gjyqtarja Igerta Hysi ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar nga asnjë prej palëve ndërgjyqëse, që do të thotë se shtetasja Zh. Q ka qenë dakord dhe ka pranuar mënyrën e disponimit nga gjykata lidhur me këtë çështje.

Komisioni vlerësoi se shpjegimet e dhëna nga subjekti ishin bindëse dhe në përputhje me ligjin.

2. Denoncim nr. **, datë 25.7.2018, depozituar nga shtetasi S. A**

Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit dhe prokurori i çështjes kanë fshehur prova të dosjes dhe nuk kanë kryer hetim të plotë të saj duke treguar njëanshmëri. Denoncuesi pretendon që i është mohuar e drejta e fjalës. Gjyqi është paragjykuar përpara se të jepej vendimi, etj.

Nga aktet e dosjes ka rezultuar se denoncuesi ka kallëzuar penalisht 2 persona të akuzuar për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, pas hetimit të kryer, ka vendosur pushimin e çështjes penale. Gjithashtu, me vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, është vendosur pushimi i çështjes penale të kallëzuar nga denoncuesi.

Në lidhje me këtë denoncim, subjektit iu kërkuan shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se: *“Lidhur me themelin e çështjes, vendimi me trup gjykues të përbërë nga unë gjyqtare Igerta Hysi, me nr.*****, datë 3.5.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është ankimuar nga palët dhe Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 3.7.2018, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi, si një vendim i drejtë, i bazuar në ligj dhe në prova. Vendimi gjyqësor, në lidhje me këtë çështje, është i arsyetuar dhe i është dhënë zgjidhje ligjore të gjitha pretendimeve të palëve në proces.*

Në lidhje me pretendimin e kallëzuesit se atij nuk i është dhënë e drejta e fjalës, mjafton t’i referoheni procesverbaleve të transkriptuara të seancave audio, të cilat po ju vë dispozicion, për të konkluduar se një pretendim i tillë është haptazi i pabazuar”.

Trupi gjykues vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në prapësime, si dhe pasi kreu verifikimet në dosjen përkatëse, referuar pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se këto dy denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e aftësive profesionale.

3. Denoncim nr. ** prot., datë 27.4.2018, depozituar nga shtetasi M.S**

Denoncuesi ka ngritur pretendime për 3 subjekte rivlerësimi, ndërmjet të cilëve edhe për subjektin Igerta Hysi. Denoncuesi pretendon se këto subjekte rivlerësimi kanë bërë shkelje ligjore duke favorizuar palën tjetër kundërshtarë. Nga aktet e depozituar nga denoncuesi rezulton se shtetasja M.S ka marrë një hua nga shtetasi N.H, me kërkesë të të cilit, subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, ka urdhëruar lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për huan e marrë.

Denoncuesi nuk rezulton në asnjë nga aktet dhe nuk evidentohet të jetë palë ndërgjyqëse në dy vendimet që janë depozituar. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk e ka njoftuar për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit që është bërë nga subjekti Igerta Hysi. Vendimi i kësaj të fundit është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Denoncuesi pretendon në denoncimin e paraqitur se *dyshon se këta gjyqtarët kanë marrë rryshfet, fakt për të cilin disponon dhe prova.* Denoncuesi nuk ka sjellë asnjë provë për të mbështetur pretendimet e tij.

✓ **Në lidhje me pretendimet që denoncuesi ka për themelin e çështjes, ato janë objekt shqyrtimi nga gjykatat më të larta.**

4. Denoncim nr. * prot., datë 18.5.2018, depozituar nga shtetasi N.D**

Ky denoncues rezulton se ka pasur një konflikt me një banor të pallatit ku banon, pasi pretendon se i kanë shembur ballkonin e shtëpisë. Denoncuesi argumenton se ka qenë emigrant ekonomik në shtetin grek, në periudhën 1997 – 2011 dhe kur është kthyer në Shqipëri pas 14 vjetësh është njohur me faktin e dëmtimit të ballkonit.

Denoncuesi ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Fierit dhe referuar shpjegimeve të tij, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka disponuar me pushimin e procedimit pasi vepra penale për të cilën denoncuesi ka paraqitur kallëzim është parashkruar. Vendimin e Prokurorisë e ka ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe me vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, është lënë në fuqi vendimi i Prokurorisë, duke mbështetur

argumentimin për parashkrimin e veprës penale. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, sikurse shpjegon denoncuesi, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Denoncuesi nuk ka depozituar dokumentacion mbështetës për pretendimet e tij. Denoncuesi ngre pretendime në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës, që lidhet me themelin e çështjes, e cila mund të zgjidhet nga gjykatat më të larta.

5. Denoncim anonim nr*, datë 21.3.2018, depozituar në faqen zyrtare të Komisionit**

Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, ka një pronë të fshehur në emër të vëllait, te zona e ish-parkut të autobusave në Tiranë. I vëllai është administrator i lokalit dhe paraqitet si pronar. Lokali ka kushtuar 500.000.000 lekë.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se referuar përgjigjes së marrë nga ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Jug³⁰, në emër të shtetasve M.V. B dhe M.M.B është regjistruar pasuria me nr. ****-N***, z. k. ****, vol. ***, f.***, e llojit njësi me sip. 117.4 m², me vendndodhje në “Rruga e Kavajës”, Tiranë.

Bashkëlidhur rezulton kartela e pasurisë së paluajtshme të njësisë me sip. 117 m², nga ku rezulton se kjo pronë është hipotekuar në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, sipas kontratës së hipotekimit të datës 29.10.2012.

Kjo pasuri është blerë nga shtetasit M dhe M.B me kontratën e shitblerjes nr. *****, datë 13.4.2016, në shumën 130.000 euro. Si burim krijimi për këtë pasuri ka rezultuar kredia bankare e marrë nga blerësit në UBA, në shumën 14.000.000 lekë. Shuma e këtij detyrimi bankar, të mbetur pa u shlyer deri në datën 24.1.2017 është 13.095.653 lekë.

✓ Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nuk u evidentua ndonjë problematikë.

6. Denoncim nr. **, datë 28.10.2019, depozituar nga shtetasja N.Xh**

Denoncuesja ka ngritur pretendime për një prokuror dhe për subjektin e rivlerësimit që kanë shqyrtuar çështjen e saj dhe pretendon se kanë treguar njëanshmëri të dukshme, pasi pala tjetër në proces është me profesion avokat dhe është mik me subjektet e rivlerësimit.

Denoncuesja ka një konflikt pronësie për të cilën është akuzuar sa ka falsifikuar dokumentacionin e pronësisë. Nga shqyrtimi i akteve të depozituar nga denoncuesja, por edhe nga përmbajtja e denoncimit nuk u evidentua të ishte referuar emri i subjektit të rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, dhe as përshkrimi i ndonjë të dhëne apo veprimi procedural që lidhej me të.

Komisioni, pas analizimit të denoncimeve, referuar nenit 53, të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vlerësuar se denoncimet nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Nga hetimi i thellë administrativ i kryer, nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e gjyqtarës Igerta Hysi dhe sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “e aftë”.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

³⁰ Me shkresën nr. **** prot., datë 24.3.2020.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Igerta Hysi, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 11.1.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Suela ZHEGU
Relatore

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha

